



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 27 datë 10.5.2022

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. LORO GOCAJ , Z. MARTIN SOKOLI , Z. SOKOL DEMA , ZNJ. LIRJANA BICI DHE Z. ASTRIT KALAJA , BANESAT E TË CILËVE U JANË DËMTUAR NGA ZJARRI.

Këshilli Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës 10.5.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, neni 54 shkronja “dh”; ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, VKM-së nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, VKM-së nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB Nr 3 datë 05.01.2022 “ *Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë së Shkodrës*” i ndryshuar , Shkresa me Nr. 3950 Prot.,

datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në Relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **z. Loro Gocaj** (2 anëtarë familje), në vlerën prej 40 000 (dyzet mijë) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Loro Gocaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 1 699 012 (njemilion e gjashtëqind e nentëdhjetë e nentemije e dymbëdhjetë) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 512 380 (peseqind e dymbëdhjetë mije e treqind e tetëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Loro Gocaj** .
3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **z. Martin Sokoli** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000(njeqind mijë) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Martin Sokoli** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 1 373 673 (njemilion e treqind e shtatëdhjetë e tremije e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 317 900 (treqind e shtatëdhjetë mije e nentëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Martin Sokoli** .
5. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **z. Sokol Dema** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (njeqind mijë) lekë , për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
6. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Sokol Dema** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 608 850 (gjashtëqind e tetemije e teteqind e pesëdhjetë) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 423 460 (katerqind e njezet e tremije e katerqind e gjashtëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Sokol Dema** .
7. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **znj. Lirjana Bici** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000(njeqind mijë) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.

8. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **znj. Lirjana Bici** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 902 098 (nenteqind e dymije e nentedhete e tete) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 350 300 (treqind e pesedhete mije e treqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **znj. Lirjana Bici** .
9. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **z. Astrit Kalaja** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000(njeqind mijë) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
10. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Astrit Kalaja** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 410 400 (katerqind e dhjetemije e katerqind) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 435 380 (katerqind e tridhete e pesemije e treqind e tetedhete) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Astrit Kalaja**.
11. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin P03280 “ Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2022 të miratuar me VKB nr 3 . datë 05.01.2022, në programin P03280, O1 A2 “ Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 440 000 (katerqind e dyzetmijë)lekë.
12. Për familjen e **Z. LORO GOCAJ , Z. MARTIN SOKOLI , Z. SOKOL DEMA , ZNJ. LIRJANA BICI DHE Z. ASTRIT KALAJA** kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore sipas preventivave si dhe në orendi e pajisje do të bëhet në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile “ pika 3.1/a nga fondet e kushtëzuara që do të akordohen nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022 për Bashkinë Shkodër sipas Relacionit bashkëngjitur në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 2 497 016,⁵ (dymilion e katerqind e nentedhete e shtatemije e gjashtembedhete presje pese) lekë dhe ne 50% të vlerës së orendive në shumën 1 019 710 (njemilion e nentembedhete mije e shtateqind e dhjete) lekë .
13. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme në shumës prej 440 000 (katerqind e dyzet mijë)lekë nga Buxheti i Bashkisë .
14. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

15. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Leşha

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 16.5.2022